



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/1058**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-kryetare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Naim Shuki B.I.” kundër Njoftimit për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për te sëmurit” me nr. të prokurimit: "70010-23-5909-1-2-1" të Spitalit Regjional Prizren, më 08/03/2024, mori këtë:

### **Vendim**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE “Naim Shuki B.I.” e datës 25.12.2023 me nr. prokolli 2023/1058, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për te sëmurit” me nr. të prokurimit: "70010-23-5909-1-2-1" inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Spitali Regjional Prizren kurse Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – Spitali Regjional Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

2. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 16/06/2023, Spitali Regjional Prizren në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për te sëmurit” me nr. të prokurimit: "70010-23-5909-1-2-1". Ndërsa me datën 06.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 50,301.00 €.

Me 11.12.2023, OE “Naim Shuki B.I.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 28.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 25.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Naim Shuki B.I.” me nr. 1058/23 lidhur me aktivitetin “Blerja e uniformave për personelin mjekësor, personelin teknik dhe qarshafa për te sëmurit” me nr. të prokurimit: "70010-23-5909-1-2-1".

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Naim Shuki B.I.” janë parashtruar si në vijim:*

*Pretendimi i parë (I) dhe pretendimi i dytë (II):* “OE ankues pretendon që: “OE ankues është eliminuar padrejtësisht për disa arsye të dhëna nga AK. POZ1- Për matjet që kanë bërë komisioni nuk është profesional dhe nuk janë certifikuar për matje tekstilit dhe nuk ka mundësi me dore të kuptohet se sa është përqindja e Poliester e sa Pambuk. POZ2- 2 Dosje Tenderit Për matjet që kanë bërë komisioni nuk është profesional dhe nuk janë certifikuar për matje tekstilit dhe nuk ka mundësi me dore të kuptohet se sa është përqindja e materialeve & ngjyra e kërkuar në Aneksin 1 Dosjes Tenderit është vetëm Gjelbërit (Nuk është specifikuar me numër ngjyrës apo Gjelbërit e mbyllur ose hapur etj.). Kështu që ngjyra dhe materiali e përmbush kërkesën AK sipas Dosjes Tenderit ANEKSI 1.” *Pretendimi i tretë (III):* “POZ5- Për LOGO në mostra nuk kemi hasur në asnjë Tender të kërkohej logoja të qepet në mostra përveç nëse jemi fitues kërkohej mosra me llogo dhe ceket në Dosjen e tenderit ose kërkohej llogo të qepet veçanërisht në një material gjithashtu kërkohej në dosjen e tenderit (në të kundërtën në mostra kur qepen logoja për OE që eliminohen nuk kanë drejt të përdorin ato mostra sepse simbolizon një institucion dhe gjithashtu në si OE kemi humbje dhe duhet të paguhet nga AK dhe ceken në Dosjen e tenderit, një gjë e tillë nuk ka ndodhur me AK-ne.”

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1, 6, 7, 59, 60, të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues në përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ka theksuar se OE ankues është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet sepse sipas komisionit profesional të vlerësimit, të gjeturat e mostrave të OE “Naim Shuki” B.I Poz. 1 Uniformë për personelin medicinal me ngjyre të bardhë, Pantallonat kanë material tjetër nga bluzat, nuk është materiali i njëjtë (përmbajtja me

shume poliester POZ. Uniforma për salla te operacionit te gjelbërta bluze dhe pantallona. Bluza është sipas specifikave te kërkuara, ndërsa pantallonat ne përmbajtje dhe me ngjyre nuk i përshtaten ngjyrës dhe kualitetit te bluzave (duhet te jene komplet me ngjyre dhe kualitet.) POZ.5 jakne e gjate dimri me mbishkrim ne shpine dhe logo e qepur ne gjoks materiali 65% poliester 35% pambuk pjesa e brendshme me lio -Mungon mostra me mbishkrimin dhe logon e spitalit. Asnjëra nga këto pozicione (Mostra) Nuk janë sipas kërkesës se AK.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1058/23, ndërsa me datë 12.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 23/1058 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

*Lidhur me pretendimet e OE "Naim Shuki B.I." eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1058 ka vlerësuar si në vijim:*

*Sqarim hyrës:* "Sqarim hyrës: Pretendimet të cilat janë ngritur nga OE ankues janë kryesisht pretendime ankimore me karakter teknik, eksperti shqyrtues ka pasur mundësi të përgjigjet vetëm në njërin pretendim si më poshtë". *Konstatimi i parë (I) dhe i dytë (II):* "Sa i përket pretendimeve të ngritura nga OE ankues për dy arsyetimet e para të eliminimit nga AK, eksperti shqyrtues duke marr parasysh se nuk është i profilizuar si profesionist i materialeve dhe tekstilit, fillimisht ka bërë kërkesë për ekspert teknik të fushës përkatëse, por duke marr parasysh se OSHP momentalisht nuk ka ekspert të kësaj fushe, atëherë ankesa është dashur të trajtohej vetëm nga eksperti shqyrtues. Sa i përket këtyre dy pretendimeve të para, siç e ceka edhe më lartë eksperti shqyrtues nuk është i profilizuar profesionalisht për të shqyrtuar pretendimet sa i përket materialeve dhe përbërjes së tyre". *Konstatimi i tretë (III):* "Sa i përket pozicionit 5, në Dosje të Tenderit, tek pjesa e Aneksi 1- Specifikimet teknike të detyrueshme, është kërkuar që operatorët ofertues duhet të dorëzojnë Jakne të gjatë dimri, me mbishkrim dhe shpinë dhe llogon e qepur në gjoks. Një nga arsyet e eliminimit të OE ankues ka qenë edhe pse ky operator nuk ka ofruar mostrën e kërkuar me mbishkrimin dhe logon e spitalit. Nga pretendimi më lartë, shihet qartë se edhe vet OE ankues ka pranuar që nuk ka dorëzuar jaknën e cila e ka edhe llogon e spitalit sepse siç ceket nga operatori ankues, kur logo qepet nga një OE i cili eliminohet, e njëjta mostër nuk mund të përdoret diku tjetër sepse simbolizon një institucion dhe një gjë e tillë sjellë humbje për operatorin. Sipas ekspertit, çdo kërkesë e DT-së duhet përmbushur nga operatorët pjesëmarrës, mos përmbushja e kërkesave të DT-së, tregon joseriozitet të operatorëve dhe mundëson edhe eliminimin nga aktiviteti i prokurimit. Duke qenë se OE ankues e pranon edhe vet përmes ankesës se nuk ka dorëzuar jaknën me logo ashtu siç është kërkuar, atëherë mendimi i ekspertit shqyrtues është se OE ankues nuk ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nga kjo që arsyetuar, konsiderojmë që ky pretendim nuk është i bazuar. Nga ajo çfarë shpjegojmë më lartë, eksperti edhe njëherë thekson se edhe pse nuk mund të ipen përgjigje në dy pretendimet e para, duke marr parasysh se për pozicionin numër 5, OE ankues nuk i ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit, atëherë edhe eksperti konsideron që kjo pikë është arsye e cila nuk e bënë të përgjegjshëm operatorin ankues."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, kurse OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

*- Konstatimet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se bazuar në njërën nga arsyet e eliminimit të ankuesit si përcaktuse për këtë aktivitet është cituar se operator ekonomik tani ankuesi nuk ka ofruar mostrën e kërkuar me mbishkrimin dhe logon e spitalit., lidhur me këtë ekspert ka konstatuar se sa i përket pozicionit nr.5, në Dosje të Tenderit, tek pjesa e Aneksi 1- Specifikimet teknike të detyrueshme, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ofertues duhet të dorëzojnë Jakne të gjatë dimri, me mbishkrim dhe shpinë dhe llogo e qepur në gjoks" kurse nga shkresat e ankuesit shihet qartë se të nejtut nuk e kanë mohuar se nuk e kanë plotësuar këtë kërkesë për me tepër kanë pohuar mes tjerash se "*kur logo qepet nga një OE i cili eliminohet, e njëjta mostër nuk mund të përdoret diku tjetër sepse simbolizon një institucion tjetër dhe rrjedhimisht një gjë e tillë sjellë humbje për operatorin*" Paneli sqaron se çdo kërkesë e DT-së duhet përmbushur nga operatorët pjesëmarrës, ngase mos përmbushja e kërkesave të DT-së, tregon një joseriozitet të operatorëve dhe njëherish përbënë arsye për eliminimin e tij/saj nga aktiviteti i prokurimit. mbi bazën e të lartëcekurave vërtetohen se nuk është kontestuse se ankuesi nuk ka ofruar konformë kërkesave të vendosura në DT, andaj rrjedhimisht eliminohet si i papërgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit.

OSHP sqaron se çdo herë që publikohet njoftimi për kontratë nga ndonjë autoritet kontraktues, palët e interesuara kanë të drejtë ti kundërshtojnë kriteret e vendosura në Dosje të tenderit [DT] para autoriteteve kontraktuese [AK] dhe në shkallë të dytë pranë organit Shqyrtues të Prokurimit [OSHP], në të kundërtën nëse palët pajtohen me dosjen e publikuar dhe nuk bëjnë kundërshtime, ato janë të obliguara të paraqesin ofertën e tyre në përputhje të plotë me kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK) e cila pastaj obligohet të veproj sipas nenit 59.4 cituar "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

AK, me tej ka shpjeguar se është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave në mënyrë të barabarte dhe në harmoni me LPP dhe kërkesat dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë,

nga të cilat ka rezultuar se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i përgjegjshëm, sepse ka ofruar ofertën e përgjegjshme me çmimin më të lirë ngase i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe të njoftimit për kontratë sipas LPP, në krahasim me ofertën e ankuesit e cila nuk i plotëson të gjitha kërkesat e AK. Paneli shqyrtues thekson se në këtë rast duhet kujtuar se autoriteti kontraktues nga cilësia e tij si institucion i administratës publike ka kapacitetet organizativ dhe profesional dhe ka të drejtë që ta themelojë komisionin vlerësues i cili është përgjegjëses për procesin e vlerësimit të tenderëve, sikurse kërkohet kjo shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 59 të LPP-së. Kurse sipas nenit 24 të ligjit të cituar “autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” e duke vazhduar me kujdesin e tij/saj në implementimin e drejtë të dosjes së tenderit dhe siç kërkohet me dispozitën e nenit 59 të LPP “të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”

Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, natyrisht se secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit. Andaj Paneli Shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së “*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*” kur ka refuzuar ofertën e OE ankues si të papërgjegjshme.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën 1 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën 2 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vjosa Gradinaj**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur mund ti drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti për çështje asministrative për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - SPITALI REGJIONAL - PRIZREN**
- **OE - Naim Shuki B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: